

VENDIM
Nr. 195, datë 19.6.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikave 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/4 prot., datë 16.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EU Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271 prot., datë 18.4.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. ERE, me *e-mail*-in e datës 26.4.2023, i evidentoi shoqërisë gjetjet e saj pas dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionin plotësues që duhet të përcillte në kuadër të aplikimit. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271/2 prot., datë 2.5.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u evidentua se shoqëria nuk ishte e qartë, për këtë arsye më datë 5.6.2023, ERE zhvilloi një seancë dëgjimore me shoqërinë. Në vijim të seancës dëgjimore, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1273 prot., datë 6.5.2023, paraqiti dokumentacion plotësues për aplikimin.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a”, “c” dhe “d” dhe për pikën 1.3, ghermën “a”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 2.5. Shoqëria duhet të nënshkruajë dhe/ose të vulosë dokumentin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti